



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-D/DPK
Nr. fletë Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	01-4479/15
Data Datum Date	26.11.2015



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 26.10.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr AKK-03-02-1333/15, për z. Aziz Thaçi, Kryesues i Kuvendit Komunal të Malishevës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej, ndërsa ushtrimi i funksionit si Kryesues i Kuvendit Komunal të Malishevës dhe njëkohësisht Mjekë – Stomatolog në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Malishevë nuk paraqet konflikt Interesi.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Aziz Thaçi, Kryesues i Kuvendit Komunal të Malishevës, person i autorizuar në një biznes privat dhe njëkohësisht Mjek – Stomatolog në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Malishevë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas pranimit të informacionit për dyshimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit sipas të cilit zyrtari i lartë z. Aziz Thaçi si Kryesues i Kuvendit Komunal të Malishevës, ushtron funksionin si person i autorizuar në biznes privat, ndërsa sipas raportuesit të rastit z. Thaçi duhet që krahas ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik të pezullojë edhe funksionin si Mjek – Stomatolog në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Malishevë duke u bazuar në Ligjin e Punës Nr.03/L-212.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Zyrtarët e Agjencisë kanë organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Në këtë rast z. Thaçi është njoftuar se gjatë ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë nuk mund të ushtroj funksionin si person i autorizuar në biznes privat, kjo për faktin se Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nr. 04/L-051 e ndalon një gjë të tillë neni 15 (paragrafi 1).

Zyrtari i lartë z. Thaçi, ka pranuar rekomandimin e Agjencisë, për të bërë ndryshimet e nevojshme në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, z. Thaçi ka dërguar në Agjenci një shkresë zyrtare të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/1984/15), në të cilën vërtetohet se zyrtari i lartë ka heq dorë nga funksioni si person i autorizuar në biznes privat.

Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar shkresë zyrtare (interpretim ligjor) të nenit 41 të Ligjit Nr.03/L-212 të punës nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në të cilën thuhet se nuk ka pengesa ligjore bazuar në Ligjin e punës Nr.03/L-212 në ushtrimin e funksioneve si Kryesues i Kuvendit Komunal të Malishevës, Mjek – Stomatolog në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Malishevë.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

